



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Rizvan Rexhaj
Pronar
KNN
OSHP037
Zona Inustriale,
Objekti i Univeristetit AAB Nr.4
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2012/16
Ref:1211/1101/KPM/ni

VENDIM

në lidhje me kërkesën e ofruesit të shërbimeve programore KNN për ndryshimin e emrit në ART

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Ofruesi i Shërbimeve Programore (OSHP) KNN, me seli në Prishtinë, është pajisur me licencë të KPM me 27 tetor 2010, për të vepruar si OSHP.
3. KPM, me datën 25 nëntor 2011, ka pranuar kërkesën nga pronari i KNN për ndryshimin e emrit nga KNN në ART.

Arsyetim

4. Kërkesa për ndryshimin e emrit të OSHP KNN në ART është bërë për shkak se, emri i propozuar është më i përshtatshëm, pasi që i njëjti është akronim i Universitetit AAB.
5. Kërkesa e pronarit të KNN për ndryshim të emrit të këtij OSHP, nuk paraqet asnjë ndryshim tjetër në Pakon e Licencës së KPM-së për këtë OSHP.


6. Emri i propozuar ART për t'u identifikuar në të ardhmen si OSHP në Republikën e Kosovës, nuk është i ngjashëm me asnjë nga emrat e subjekteve transmetuese të licencuara nga KPM dhe që operojnë në Republikën e Kosovës.

Vendim

7. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon që ndryshimi i emrit të OSHP KNN në ART nuk paraqet ndryshime në pronësi apo në skemën e propozuar programore.
8. Komisioni i Pavarur për Media, merr vendim që OSHP KNN t'i lejohet ndryshimi i emrit në ART.

Lëshimi i Vendimit

9. Këtë vendim e lëshon Komisioni.



Shafki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



15.11.2012
datë